

BIBLIOTEKA
SHTETIT

854-2
Bla 25

TODI THANASI



KOHA E KOMISARËVE

DRAMË

884-2
8625

TODI THANASI

KOHA E KOMISARËVE

D r a m ë

(Sipas disa motiveve të romanit «Komisari Memo»
të Dritëro Agollit)



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

PERSONAZHET

KOMISARI MEMO

KOMANDANTI RRAPO

XHEMAL PORODINA

NURKA

FATJA

HODO ALLAMANI

XHODO GRENI

MAK MOKRA

MEVLANI

ALMA

NAFIJA

BALJA

ZARIKU

XHA JASHOJA

VALIDEA

ZYLOJA

ENRIKOJA

— zëvendëskomisar

— intendent

— komandant kompanie

— » »

— » »

— » »

— partizan

— partizane

— »

— »

— agjent

— fshatar

— e shoqja

— i biri

— ish-ushtar italian

PARTIZANË DHE PARTIZANE.

P A R A S K E N È

Memo Kovaçi lexon letrën e Qarkorit të Partisë:

«Pas mbledhjes me përgjegjësat e këshillave, mos u kthe në Qarkor, po nisu sa më shpejt te komandanti Rrapo, në batalionin «Shkrepëtima», ku caktohesh si komisar.

Si zëvendës komisar është caktuar Xhemal Prodina. Ti duhet ta bindësh Rrapon se pa komisarë lufta nuk bëhet, pa komisarë partizanët kthehen në bashibozukë. Të veprosh si komunist dhe t'i ruhesh acarimit të marrëdhënieve komisar-komandan. Rrapoja është komandant trim dhe ka influencë të madhe në tërë krahinën. Veç kësaj, partizanët e duan. Ne nuk duhet ta humbasim këtë njëri. Për këtë arsy, disa anë të rrëmbyera të karakterit të tij, ne nuk ia kemi marrë për të keq dhe ia kemi falur. Tani ka ardhur koha që Rrapoja, nën ndikimin tonë të fortë, të shtrohet.»

Komiteti Qarkor i Partisë

MEMOJA: (*I menduar*) Komandanti Rrapo...

NË GUR-KUSAR

Vendqëndrimi i batalionit «Shkrepëtima». Në një qoshe, Rrapoja me komandantët e kompanive bëjnë planin e pritës së autokolonës gjermane. Ai me një plis të tharë heq ca si viza mbi një gur të rrumbullakët si sofër.

RRAPOJA: (*Tregon me dorë.*) Ta zemë se kjo këtu është xhadeja. Këtu është ura, atje matanë bërryli i kthesës. Hajde tani të dëgjojmë ato mendjet tuaja. Ku ta zëmë dhe si ta zëmë pritën?

HODOJA: Komendant, unë them të vendosemi në të dy krahët e xhadesë. Me të ardhur autokolona, t'i fumi varda dhe ta bëjmë pluhur.

FATJA: Jo more! Bukur shumë! Po ata i futen shkëmbit me mortajë dhe ne të gjithë na vrasin ciflat e gurreve.

XHODOJA: Ore, po përse të mendohemi shumë. E bëjmë si herën tjetër. Futi në bërrylin e Gurit të Kuq, hidhe urën në erë dhe sulmo përsipër.

MAKU: Unë kam bërë një si biçim skice të xhadesë. (*Nxjerr skicën.*) Unë them që Hodoja me kompaninë e tij të vendoset këtu, te shigjeta e kuqe. Këtu, te kjo shigjeta mavi, të qëndrojë Fatja, kurse kjo shigjeta...

HODOJA: (*E ndërpret.*) Ama si ia fut edhe ti, Mak Mokra. Tamam si ajo e Zeqos majë thanës. Akoma me shigjeta ti, si në kohën e turkut! Me mitraloz ore, me mitraloz, që t'i vijë festja vërdallë nemces.

MAKU: E po mirë, Hodo Allamani, përse nxehesh ti? Një mendje ju dhashë.

RRAPOJA: Mirë ta bëri. Sa herë të kam thënë që të mos këndosh libra, se ta prishin mendjen ato, ti prapë-serapë me tënden. Mbaje me shëndet tani.

XHODOJA: O Mak, e pësove si breshka te nallbani. (*Qeshin*)

RRAPOJA: Po ti, o Fate, ç'na thua?

FATJA: Si të thuash ti, o komandant!

RRAPOJA: Hëm! (*Mendohet*) Pyka jeni. S'merrni vesh nga punët e luftës. A, më kënaqët shumë me këto mendjet tuaja. Bylmezë jeni të gjithë! (*Hyn një partizan.*)

PARTIZANI: Komandant, të kërkojnë dy shokë.

RRAPOJA: Le të vijnë.

(*Partizani largohet. Rrapoja vazhdon të shpjegojë planin e pritjes. Gjatë kësaj kohe, afrohen Memoja dhe Xhemali.*)

RRAPOJA: S'kuptoni asgjë nga takтика. Pyka jeni!

XHEMALI: (*Memos*) Ç'bën ky?

MEMOJA: Mësim ushtarak, ndoshta shkruan në gurë, si në dërrasë të zezë. (*Ata i ka rrëmbyer plani i pritës dhe nuk po i vështrojnë të porsaardhurit*) Punë të mbarë! (*Ata kthejnë kokat*).

RRAPOJA: A, komisarët! Mirë se vini, mirë se vini! (*Ngrihet vrik në këmbë dhe u zgjat dorën.*) Si veni? U lodhët!

XHEMALI: Pak!

RRAPOJA: E po mirë, çlodhuni! (*Kthehet nga komandanët.*) Ku e lamë? Ë, po! Këtu është xhadeja (*Bën një shenjë*) Ti me kompaninë tënde do të zësh vend këtu. Ti, Fate, me kompaninë tënde këtu. Fap këtu! (*Bën një rreth*) Gjermani me makina vjen këtej. (*Heq një vizë në shenjën e xhadesë.*) Unë me kompaninë time do të zë vend këtu. Gjermani vjen. Unë rri e s'bëj zë. Hiç, as gëk, as mëk. Hyn

gjermani. Mbaron bishti i kolonës. Unë fap ia bëj dhe ua ndez prapanicat e ua shpoj rrotat, e ua bëj shoshë kokat. Nga pas, de! Gjermani hutohet. Demek hutohet, se s'para hutohet ai qen. Gjermani kthehet nga unë. Atëherë ju fap ia bëni dhe në të s'ëmës hitlerica dhe himlerica. (*Heq disa viaj në gurë. Ata qeshin.*) Fate, mos m'i zbardh dhëmbët, se ndryshon puna këtu në gurë dhe atje në xhade. Si thashë? Mos zbardh dhëmbët. (*Heq përsëri viza pastaj shfryn.*) Mbaruam. Nesër në tre të natës, në kodrat mbi xhade. Në dy të natës, nisemi. Në tre të natës, në vend. (*Shkund duart nga pluhuri, merr kapelen dhe e ngjesh në kokë.*)

MEMOJA: (*Xhemalit*) Ky na harroi fare!

XHEMALI: E ka rrëmbyer plani i luftës.

FATJA: Të ikim ne?

RRAPOJA: Unë thashë të ikni! (*Memos dhe Xhemalit*) Demek, erdhët. Bukur, bukur! Kam dëgjuar për ty, ke qenë i plagosur. Të futën në qytet dhe atje u shërove. Edhe unë jam plagosur në krah. U shërova. Sali Protopapa më plagosi. I poshtër, është. Pusht është e qen bir qeni është, nursëz është e çapaçul është. Qurraman është e kujton se është trim. Edhe ty, ai të plagosi?

MEMOJA: (*E mban me zor të qeshurën*) Horrat e tij.

RRAPOJA: Edhe ata çapaçulë janë. Dhëmbët do t'u shkul. (*Memoja sheh darën që mban Rrapoja në brez dhe padashur vë dorën në faqe.*) Të dhëmb dhëmbi? Kam darë unë. (*Fut dorën në brez*)

MEMOJA: (*Shpejt.*) Jo, jo!

RRAPOJA: Jo, po thashë.

XHEMALI: Siç ju kanë njoftuar, Memo Kovaçi është caktuar nga Qarkori komisar në batalionin tuaj. Unë jam zëvendëskomisari!

RRAPOJA: Mirë, mirë. Tani e kemi hallin tek ajo prita që do të zëmë nesër në xhade buzë Kamjes. Po të na dalë mirë, zgjidhet edhe puna e komisarëve.

XHEMALI: Po të mos dalë mirë, nuk zgjidhet?

RRAPOJA: Zgjidhet, po nuk do të jemi në qejf.

MEMOJA: Po ne nuk do të rrimë duarkryq. Edhe ne do të vijmë në pritë.

RRAPOJA: Jo! Ju do të rrini këtu! Nuk e dini as vendin as planin.

MEMOJA: Vendin e dimë. Planin e mësojmë.

RRAPOJA: (*I inatosur*) Jo! Ju nuk dini asgjë për pritën dhe na i bëni çorbë kompanitë. (*Pauzë*) Gjer në darkë kemi kohë të merremi vesh. Tani le të njihemi me shokët. (*Shkëputen katër veta e dalin përrpara.*) Ky është komisari! Ky është zëvendësi! (*Shtrëngojnë duart.*)

FATJA: Fatja!

XHODOJA: Xhodo Greni!

MAKU: Mak Mokra!

HODOJA: Hodo Allamani!

(*Rrapoja vështron Faten.*)

FATJA: Gati janë, komandant!

RRAPOJA: Bjeruni borisë të mblidhen (*Fatja bën me shenjë. Bie boria për mbledhje. Partizanët grumbullohen. Rrapoja vështron komandanët e kompanive*) Para kompanive!... Ç'më vërtiteni mua, sikur jam mbreti Metaksa! (*Fatja, Xhodoja, Maku dhe Hodoja largohen. Rrapoja fillon fjalimin*) Vëllezër e djem! Përse i mbajmë dyfekët në sup dhe koburet në brez? Ja, ti, Nurkë, që ke dyfek dhe kobure, më thuaj, përse i mban ato të shkreta?

NURKA: I mbaj, o Rrapo vëllai, që t'ia hedh trutë në erë nemces dhe Ballit. I mbaj, o Rrapo vëllai, që në të s'ëmës t'i dërgoj lapangjozët. (*Partizanët qeshin.*)

RRAPOJA: Boll, boll se e zgjate shumë! Mjafton që t'ia hedhësh trutë në erë nemces dhe Ballit. Mirë e tha Nurka: t'ua hedhim trutë në erë gjermanit dhe Ballit! E kur do t'ua hedhim në erë? Ë? Pas një viti, apo pas një muaji? Jo, more, jo; nesër, ore, nesër në orën tre allafranga. Atje në xhade do t'ua hedhim... Nesër vjen autokolona gjermane nga Follorina. Ne do t'i presim jo me temenanë e Sali Protopapës, po me temenanë tonë, se janë të poshtër dhe vrasës, janë xhelatë dhe kriminelë, zuzarë dhe edepsezë. Dhe harram na qoftë ky bar e këto lisa, kjo tokë e këta gurë, po s'ua dhjemë t'ëmën! Qentë e qenit, duan të shijnë në vendin tonë sikur janë te hitlerica, tek ajo bushtra e bushtrave... Fate, hajde, fol për atë që menduam sot. (*Fatja zë vend në krahun e majtë të Rrapos.*)

FATJA: Sulmin e kemi gjykuar për nesër në orën tre. Do të nisemi që në orën dy pas mesnate. Do të arrijmë në Qafë Gomare e do të zëmë vend në të dy anët e xhadesë. Nuk do të lëvizim fare, vetëm do të presim kur do të hyjnë gjermanët. Nuk do të qëllojmë gjersa komandanti Rrapo të hapë zjarr nga pas. Me të dëgjuar komandantin Rrapo, do ta bëjmë zjarr dynjanë! Kujdes mos të ngjasin aksidente!

RRAPOJA: Thuaji mos ia mballasin njëri-tjetrit. (*Partizanët qeshin, Memoja dhe Xhemali vështrojnë njëri-tjetrin, pastaj qeshin dhe ata.*)

FATJA: Mirë thotë komandanti Rrapo. Kujdes! Mos e bëjmë si kompania e Mak Mokrës në xhadënë në fund të grykës së Gur-Kusarit që, jangëllësh, i hapi zjarr kompanisë së Hodo Allamanit dhe e plagosi Hodon në kërcin e veshit. Hapni sytë!

RRAPOJA: (*Lëviz krahun*) Fate, mjaft e zgjate. Fol për gjumin dhe për çlodhjen.

FATJA: Po. Duhet tē biem herët dhe tē çlodhemi. Gjermanë do tē ketë shumë. Kaq kisha. (*Vështron Rrapon, ai bën me kokë. Fatja shkon në vendin e tij. Heshtje.*)

RRAPOJA: (*Duke treguar komisarët.*) Ju dò tē thoni se cilët janë këta? E? Ja, tē pyesim Nurkën. Si ta merr mendja ty, Nurkë?

NURKA: Rrapo vëllai, ata janë tē Qarkorit. Dhe ata dinë ta lozin gishtin se janë burra.

RRAPOJA: Mirë e tha, Nurka. Janë tē Qarkorit dhe vijnë te ne njëri si komisar dhe tjetri si zëvendës. Janë Memo Kovaçi dhe Xhemal Porodina. (*Thirrje: Rrofshin komisarët! Rrofshin!*) Ja kështu! Tani çlodhemi! Nesër bëhet zjarr dynjaja! (*Partizanët fillojnë tē shpërndahanë.*)

ZARIKU: (*Duke i thënë shokut.*) Ky do t'ia mbledhë Rrapos.

MEMOJA: (*Që e ka dëgjuar.*) Ai djali, partizan i vjetër është?

RRAPOJA: Ai? Është Zariku. Nuk është dhe aq i vjetër. Ka ca teka po do tē ndreqet! Pse?

MEMOJA: Kot. Më tërhoqi vëmendjen fizionomia e tij.

RRAPOJA: È?

MEMOJA: Fizionomia!

RRAPOJA: Ç'është kjo fozmi?

MEMOJA: (*Duke qeshur*) Pamja, fytyra...

RRAPOJA: È, hë!

MEMOJA: Partizanë tē sëmurë ka?

RRAPOJA: Shumë pak. Nja tre a katër i ka zënë gripi, po janë djem tē shëndoshë dhe ia hedhin. (*Tregon një kasolle.*) Ju do tē flini atje. Gjykova njëherë tē mos ju merrja në pritën e nesërme, po m'u prish mendja. Do tē vini në kompaninë ku do tē shkoj unë. Mirë? Po shkoj tē fle nga Fatja. Jeni tē lo-

dhur dhe jua lirova kasollen! Ë? Si thashë? Të lodhur. Natën e mirë!

MEMOJA: Natën e mirë!

RRAPOJA: Në orën tre!

XHEMALI: Natën e mirë! Faleminderit! (*Rrapoja largohet*)

MEMOJA: Rrapon e duan partizanët! Flet si t'i vijë, por është trim, dhe trimi respektohet!

XHEMALI: Trim, por i krisur.

MEMOJA: Natyra e tij guximtare e ka bërë që të mos i shtrohet asnjë discipline.

XHEMALI: Edhe i rrëmbyer është.

MEMOJA: Nuk ka të bëjë se është i rrëmbyer... njerëzit e tillë nganjëherë zbuten më kollaj.

XHEMALI: Mundet. (*Pauzë*)

MEMOJA: Nga do t'ia fillojmë?

XHEMALI: Komandanti Rrapo duhet drejtuar. Ose më mirë... edukuar!

MEMOJA: Me njerëz të tillë duhet takt i madh.

XHEMALI: Punë delikate...

MEMOJA: Shkojmë.

PRITA PARTIZANE

RRAPOJA: (*Thërret*) Hodo, o Hodo!

HODOJA: Urdhëro!

RRAPOJA: Afrohu! (*Vjen Hodoja*) Ti do të zësh vend në mes të kompanisë. Unë me komisarët do të rri këtu pranë garagaçit. Zeqo mitralieri do t'i vendosë këmbët e mitralozit te sqepi. Nurka do të rrijë i fundit te krahu tjetër. Duhet ta mbushim radaken që kompania jonë është e para që do të hapë zjarr dhe zja-

rri i parë duhet tē jetë zjarr dhe jo flakë dëllinje. Gjermani duhet t'i mbushë brekët. Le që ai qerrata s'i mbush kollaj, po demek. E more, se mirë e thashë. Gjermani nuk éshtë kushedi se çfarë. Lufton, po édhe mundet. (*Pauzë*)

MEMOJA: Akoma nuk ka zbardhur.

XHEMALI: Kushedi se kur do tē vijnë.

RRAPOJA: Gjermani nuk udhëton në errësirë, pret tē gdhihet. Në errësirë e trembin malet.

MEMOJA: Ashtu éshtë.

XHEMALI: Po sikur ta ndérrojnë planin e tē mos nisen sot?

RRAPOJA: Kam informata tē sakta. Më lajmëroi mësuesi.

MEMOJA: Mësuesi?

RRAPOJA: Po.

XHEMALI: Ku éshtë mësuesi?

RRAPOJA: Në qytet. Do tē vijë këto ditë tē sjellë ca materiale pér shtypshkronjën e Gur-Kusarit. E njihni Mësuesin?

MEMOJA: E kam shok.

RRAPOJA: Me këtë punë merret ai. Shtyp libra dhe gazeta. Trim i madh éshtë, i zgjuar éshtë, po pér komendant nuk bën. Xhanëm, atë punë që bën ai, edhe unë nuk e bëj dot. Mirë e ka, le tē nxjerrë libra. Ato ndihmojnë, xhanëm, po nuk bëjnë gjë pér luttën. Ta prishin mendjen më keq. Kemi ne Mak Morën, që ka pak haber nga librat. U hutua njëherë në një pritë e, në vend që t'ia vërviste gjermanëve, ia veshi kompanisë së Hodos. E dëgjuat si e tha Fatja?

MEMOJA: Po tani, hutohet?

RRAPOJA: Xhanëm tani nuk hutohet se nuk lexon libra, ia kam ndaluar, se po filloj tē lexojë, ndonjë ditë

do të ma veshë edhe mua! Kur të çlirohemë, le të lexojë sa të dojë.

MEMOJA: (*Rrapos*) Po ti nuk je hutuar kur ke rënë në përpjekje?

RRAPOJA: Xhanëm, edhe unë jam hutuar.

MEMOJA: Atëherë hutimi nuk vjen nga librat.

RRAPOJA: Vjen, ore, vjen!

MEMOJA: Librat të bëjnë më trim.

RRAPOJA: Finok të bëjnë, po jo trim.

MEMOJA: Nuk është e vërtetë! (*Vjen Hodo Allamani*)

HODOJA: Unë them, o komandant, Zeqoja tă vendosë mitralozin te kërpudha.

RRAPOJA: Jo, ore, jo. Atje thashë unë, në sqep. (*Hodoja largohet. Pauzë*)

XHEMALI: Vetëm ylli i mëngjesit ka mbetur.

RRAPOJA: Po nuk iku ylli i mëngjesit, nuk vijnë gjermanët. Ylli i tremb! (*Rrapoja vë dorën tek ylli i kapeles dhe qesh. Qeshin edhe ata. Pauzë*) Si vajtët mbrëmë? A u ngopët me gjumë?

XHEMALI: Çka.

RRAPOJA: Ne me Faten nuk fjetëm fare. Pinim duhan dhe mendonim, mendonim për ato që do të ndodhin sot edhe për ato që kanë ndodhur përpara. U lodhëm dhe filluam t'ia merrnim një kënge. Pastaj prapë filluam të mendojmë. Fatja mendonte përgruan që e ka lënë andej nga Devolli me dy fëmijë. Ia kanë djegur edhe shtëpinë, të ziut, dhe gruaja jeton te një xhaxha i saj! Pa bukë s'kanë, pa veshje s'kanë. Unë s'kam ç'të mendoj për shtëpinë! (*Pas pak*) Por edhe unë mendoja. Një grua që kam pasur më vdiq. Më la një fëmijë gjashtë muajsh. E mbështolla fëmijën me pelena, e futa nën gunë dhe e çova në stan, te një miku im. Çobani kishte një grua të mirë, po pa fëmijë. U gjëzuan të shkretët

se fëmijët e bëjnë kasollen të qeshë, o komisarë! Nuk e kam parë asnëjherë! Gjallë është a vdekur është. Nuk dihet. Eh, mor komisarë! S'ka njeri Rrapoja, jetim ka qenë Rrapoja. Një fëmijë ka Rrapoja, dhe ai s'dihet! Ja, ka Rrapoja batalionin.

XHEMALI: Nuk ju dëgjuam fare, kur këndonit.

RRAPOJA: Ishit të lodhur! Kështu bëjmë ne me Faten: para betejës rrimë e kujtojmë! Eh, Fatja! Ku ka si Fatja! Bashkë kemi qenë nëpër burgje në kohën e Zogut, bashkë kemi luftuar në skuadrën e Mujo Ullqinakut. (*Memos*) Të dhembin plagët? Mua më dhemb krahu nga lagështia. Mirë që e kam krahun e majtë dhe nuk e kam krahun e kobures.

MEMOJA: Më dhembin pak.

RRAPOJA: Eh, dhembin këto qerrata plagë, dhembin... Mos m'u ndani sot. (*Dëgjohet zhurmë makinash*.)

MEMOJA: Ata janë!

RRAPOJA: (*Kontrollon rrugën*) Gërryen makina e luf-tës, gërryen! Ku e kanë gjetur gjithë këtë çelik, ore ju mbylltë!

XHEMALI: Po afrohen! (*Zhurma e makinave sa vete e shtohet. Ata fillojnë të numërojnë.*)

RRAPOJA: Një...

MEMOJA: Dy...

XHEMALI: Tre... (*Kalon një farë kohe. Zhurma sa vete shtohet*)

RRAPOJA: Bëhuni gati, djem! (*Pauzë*) Pesëmbëdhjetë!

MEMOJA: E gjashtëmbëdhjeta shoqërohet nga dy moto-çikleta.

XHEMALI: Mos na ikin?

RRAPOJA: Në bërrylin tjetër, te kompania e Xhodo Gredit, ura është hedhur në erë. Ashtu! Hyri dhe bishi! (*Rrapoja nxjerr koburen dhe qëllon dy herë. Fi-*

llojnë luftimet nga tē gjitha anët. Dëgjohen thirrjet e partizanëve.) Me granata djema, me granata!

XHEMALI: Gjermanët po sulmojnë drejt nesh.

RRAPOJA: T'ëmën! Të lojtur janë këta gjermanët, në këmbë luftojnë qerratenjtë. (*Partizanëve*) Mos u hutoni, trima. S'kanë ç'na bëjnë. Ngopja me mitraloz, Zeqo. (*Kërcet mitralozi i Zeqos*) Hë, hë! Asgjë s'bëre; hic, asgjë s'vrave, Zeqo tutkuni! Ngopja mirë, ngopja mirë! (*Kërcet përsëri mitralozi. Luftimet vazhdojnë. Dëgjohet vërvhellima e mortajës. Plasje*) Nënë, ore. Tani e kemi pisk me këtë djall mortajë. (*Rrapoja zë faqen me dorë*.)

MEMOJA: Rëndë?

RRAPOJA: Jo, më ra një cifël guri në faqe. (*Mitralozi i Zeqos hesht*.) O Zeqo tutkuni, ç'më hesht? Nuk e sheh se ç'bëhet?

HODOJA: (*Duke thirrur nga jashtë*.) Komandanti Rrapo?

RRAPOJA: Hë, ç'do?

HODOJA: Zeqoja u plagos rëndë.

RRAPOJA: Mos more! Dhe unë pyka e shava Zeqon! Eh, more tē uruar, si vajti puna. (*Rrapoja del*)

XHEMALI: — Përsëri po afrohen gjermanët! (*Vështrojnë andej nga tregon Xhemali*)

HODOJA: Bjeru me mitraloz.

MEMOJA: Prit, léri tē afrohen mirë, Xhemal.

HODOJA: More, ty po tē them, përse nuk ia shkel këmbëzën mitralozit.

MEMOJA: Prit, o Hodo, prit! (*Largo het*.)

HODOJA: (*Vjen*) More, dëgjon ti apo jo?

XHEMALI: Dëgjoj, dëgjoj, nuk jam shurdhuar.

HODOJA: Po atëherë, përse nuk qëllon?

XHEMALI: Nuk dua.

HODOJA: (*Urdhéron*) Qëllo po tē them!

XHEMALI: Mos bërtit! Nuk janë fishekët e fabrikës së tyt eti.

HODOJA: Shoku Xhemal...

XHEMALI: Shoku Hodo, nuk do të dëgjoj njëqind unë.

HODOJA: Unë jam komandant i kompanisë.

XHEMALI: Qofsh shëndoshë.

HODOJA: Pas Rrapos, duhet të më bindesh mua.

XHEMALI: Mos harro se ka edhe komisar batalioni edhe zëvendës siç jam unë, që ti kërkon të më urdhërosh.

HODOJA: Ke për të parë ti.

XHEMALI: Çfarë?

HODOJA: (*Duke ikur.*) Do të ankohem te komandanti Rrapo. (*Hyn Memoja.*)

MEMOJA: Gati, Xhemal?

XHEMALI: Gati, Memo!

MEMOJA: Jepi! (*Fillon mitralozi i Xhemalit.*)

ZËRA: Po ia mbathin, po ia mbathin. Po kthehen mbrapsht.

MEMOJA: Kështu lahen hesapet! (*Vazhdon të qëllojë mitralozi. Hyn Hodoja*)

HODOJA: More, ç'të palosur që i bëri. (*Vazhdojnë luftimet. Dëgjohen granatat.*) Ku do të jetë Rrapoja? (*Pauzë. Mbajnë vesh. S'dëgjohet më murtaja.*)

MEMOJA: Na e mori të keqen edhe mortaja. (*Xhemali vrapon te mitralozi*) Ku shkon ti?

XHEMALI: Te mitralozi. Më vjen ndorësh. (*Hyn Rrapoja*)

RRAPOJA: Kthehu. Le ta marrë Hodoja. (*Xhemali nuk bindet*) Kthehu po të them! (*Xhemali ikën. Dëgjohen të shtënat e mitralozit.*) Hajde, hajde. Qenka mitralozxhi i zoti, ky ore!

MEMOJA: Po i kosit, po i kosit!

RRAPOJA: Kërdinë po bën. (*Përsëri vërvshëllima e mortajës. Plasje*) Eh, ç'na bezdisi kjo djall mortajë. (*Thërret*) Hodo!

HODOJA: Urdhëro, komandant!

RRAPOJA: Hajde këtu! Thuaju nja tre-katër partizanëve nga skuadra e parë të marrin granatat e të vijnë me mua.

MEMOJA: Ç'ke ndër mend të bësh, Rrapo?

RRAPOJA: Ti rri kätu, unë do t'i vete mortajës. Hodo, mos qëlloni nga mortaja se mos na vrissni neve. Dëgjove?

HODOJA: Mirë, komandant! (*Largohet*)

RRAPOJA: (*Mbushet me granata*) Hap sytë se mos të të
rrethojnë.

XHEMALI: Përsëri po afrohen gjermanët. (*Ndërron vendin e mitralozit*)

MEMOJA: Kështu lahen hesapet!

ZËRI I RRAPOS: Në xhade more, në xhade.

MEMOJA: Në xhade! (*Thérret*) Përpara partizanë! (*Fillon sulmi partizan*)


ZËRI I RRAPOS: Ju ikën, more haramsëzë, ju ikën! Qëlloni në mish, more, në mish. (Vazhdojnë edhe pak luftimet, pastaj shuhën. Dëgohen tri të shtënat e nagantit të Rrapos që është shenja e mbledhjes së batalionit.)

PARASKENË

RRAPOJA: Mbaroi edhe kjo punë! (*Partizanët fillojnë të grumbullohen*)

NURKA: U takuam edhe këtë herë, o Rrapo vëllai!

RRAPOJA: Kështu do të takohemi gjithnjë, o Nurkë!



NURKA: Po mund tē takohemi edhe me gjuhë tē kafshuar! (*Partizanët qeshin.*)

RRAPOJA: Nuk kam se ç'tju mollois. E patë vetë si mbaroi përpjekja. I dogjëm dhe i thyem. Ca u vrannë, ca ia mbathën. Po tē kalojnë kötej, prapë do tē digjen edhe do tē thyhen.

FATJA: (*Ka lidhur dorën me shami*) Më shpuan, Rrapo!

RRAPOJA: E mbushe vrimën me duhan?

FATJA: E mbusha.

RRAPOJA: (*Xhodos*) Nga ti kush mungon?

XHODOJA: Maksuti dhe Abazi janë plagosur lehtë.

RRAPOJA: (*Makut*) Po nga ti?

MAKU: Asnjë!

RRAPOJA: Po Zeqoja?

HODOJA: E nisa për spital!

RRAPOJA: Ç'plaçka kanë makinat?

FATJA: Njëra ka munitione.

RRAPOJA: Shumë mirë. Të shkarkohet municioni e tē dërgohet në Gur-Kusar. Po tē tjera?

XHODOJA: Dy kanë bukë, veshje dhe plaçka.

RRAPOJA: Çfarë plaçkash?

MAKU: Fustane grash, gjerdanë, stofra...

RRAPOJA: Ashtu!....

HODOJA: Njera ka dërrasa.

RRAPOJA: (*Pasi mendohet pak*) Mirë. Buka tē shpihet në Gur-Kusar. Ato stofrat dhe fustanet do t'uashpérndajmë grave tē Lajthizës dhe tē Lumasit.

MEMOJA: (*I vrenjtur*) Nuk do t'i shpérndajmë. Do t'i dërgojmë në Vithkuq e prej andej në shtab!

RRAPOJA: (*Kthehet nga Memoja.*) Si the?

MEMOJA: Ne nuk jemi çeta tē veçuara. Ne inkuadrohemë në Ushtrinë Nacionalçlirimtare. Ne kemi një shtab tē përgjithshëm!

RRAPOJA: Sikur them t'i mbajmë për vete! Fshatarëve do t'ua japim. Vetë luftuan, vetë i zunë, vetë do t'i ndajnë si të duan!

MEMOJA: Shqipëria ka dy mijë e ca fshatra. Të veshim vetëm dy fshatra asgjë s'kemi zgjidhur. Jo. Ne do t'i dërgojmë në shtab dhe shtabi le të bëjë punën e vet.

RRAPOJA: Mua mos më dërdëllit! Unë vendos! (*Hesh-tje.*)

MEMOJA: Unë jam i dërguari i Partisë dhe mendoj se kjo është rruga më e drejtë. Çuditem, shoku Rrapo, si nuk i dini ju udhëzimet e shtabit?

XHEMALI: Shtabi ka dhënë udhëzime për materialin që i zihet armikut. (*Rrapoja vështron partizanët.*)

RRAPOJA: (*Thërret*) Fate!

FATJA: Urdhëro, komandant!

RRAPOJA: Ka ndonjë udhëzim nga shtabi për fustanet dhe gjerdanët? (*Zariku qesh me të keq.*)

MEMOJA: (*Nuk i pëlgen pyetja.*) Komandanti Rrapo, mos ve në lojë udhëzimet. Ti e di fare mirë se çdo gjë që i zihet armikut quhet material.

RRAPOJA: (*Pa u kthyer*) Unë pyes Faten!

FATJA: Në udhëzim nuk flitet për fustanet e gjerdanët, o Rrapo, po kuptoher që edhe ato materiale janë. Tani ato s'janë materiale lufte, po materiale paqeje... po në materiale hyjnë... (*Hesh-tje*)

RRAPOJA: (*Vështron Faten, buzëqesh.*) E zgjidhim pastaj. Tani të fshihen dy makinat dhe materiali. Makinave të prishura t'u mirren gomat për opinga dhe të digjen. (*Partizanët shpërndahen*)

RRAPOJA: Demek, ju thoni që malli të dërgohet në Vithkuq, ë?

MEMOJA: Po.

RRAPOJA: Po në Vithkuq si ta shpiem?

XHEMALI: I ngarkojmë në dy makina të mira dhe shkelja gazit.

RRAPOJA: Po shoferët?

MEMOJA: Xhemali është shofer.

RRAPOJA: Po janë dy makina; dreqin!

XHEMALI: Kur të shkoj në Vithkuq, u kërkoj atyre një shofer. Po s'patën, po bëj edhe një rrugë tjetër.

RRAPOJA: Hodo!

HODOJA: (*Hyn*) Urdhëro, komandanë Rrapo!

RRAPOJA: Unë me komisarët do të shkoj në Dushk. Kur të mbarosh punë, hajde dhe ti me kompaninë. Ne do të porosisim baza për të gjithë. Hajde, mirupafshim. Nisemi, o komisarë!

NË SHTËPINË E ZYLOS

Rrapoja, Memoja dhe Xhemali shoqërohen nga Zyloja. Në oborr i pret plaku i shtëpisë, xha Jashoja, dhe gruaja e tij, Validea.

ZYLOJA: Urdhëroni brenda!

VALIDEA: Erdhët, kurban nëna? Urdhëroni, urdhëroni! (*Përshëndeten*)

XHA JASHOJA: Hajde, komandanti Rrapo, hajde. Po e bëre tym dynjanë sot, or t'u mbylltë! Po ç'bën kështu, o i krisur? (*Përqafohen*) Po këta djemtë ç'janë, o Rrapo?

RRAPOJA: Ky është Memo Kovaçi, komisari i batalionit. Ky është Xhemal Porodina, zëvendëskomisari!

XHA JASHOJA: Hajdeni, or komisarët e xhaxhait. Më ju bëftë xhaxhai! (*Matet t'i përqafojë*) Dale, dale, more! Djali i Abedinit je ti?

MEMOJA: Po.

XHA JASHOJA: Hajde, o Memo, hajde! S'të njoha fare!
(*Pērqafohen*) Ama, ç'ia ke punuar mirë atij Sali
Protopapës në atë mbledhjen! Hajde, o komandanti
Rrapo, hajde, ç'i ka punuar ky Salut! Kemi ca pa-
triotë të thelave dhe të kaposhëve si Sali Proto-
papa dhe Bamkë Qylollari! — kështu i ka thënë,
o Rrapo, për nder! (*Qeshin.*) E po, jeni lodhur ca
sot! Dëgjuam, dëgjuam seç keni punuar. Unë edhe
përpara kisha dëgjuar se çoc kërcasin ato grykat e
Gur-Kusarit në xhadenë që shkon në Follorinë.
Keni bërë kërdinë mbi gjermanët. Hallall e paçi
bukën! Sot, po s'e lojte këmbëzën e dyfekut, s'ke
gjë në terezi.

ZYLOJA: Për nder, o shoku Memo, u habita kur të pa-
shë këtej. Ne të dinim të vrarë! Që atë ditë që na
mblodhe në shtëpinë e Gurit, asnje haber s'kemi
marrë!

MEMOJA: Po ja, kështu ndodhi, o Zylo!... Pas plagosjes
më futën në qytet dhe i hëngra disa javë në shtë-
pinë e doktor Borovës, gjersa m'u mbyll plaga.
Po këtej si jeni?

ZYLOJA: Mirë, o Memo, mirë!

XHEMALI: (*I jep kutinë e duhanit plakut.*) Dridhe një
herë nga ky i forti, o xha Jasho!

XHA JASHOJA: Faleminderit!

MEMOJA: Si venë punët e këshillit?

ZYLOJA: Një çikë vështirë e kemi. Ti e pe vetë ç'na pu-
noi ay Qano maskarai atë natë. Lajmëroi Sali Pro-
topapën dhe na mori në qafë dhjetë vetë nga Laj-
thiza. U pushkatua edhe i ziu Adem; ah, ç'burrë
i mirë ishte.

RRAPOJA: Ku sallhanet tani ai Qanoja, o Zylo?

ZYLOJA: Po si të them, o komandanti Rrapo? Një herë
shkoi në çetën balliste të Bamkë Qylollarit, një

herë shkoi në Korçë pas Sali Protopapës. Donte të vishej si xhandar i Saliut, por iu prish mendja. Rri ca në fshat pastaj ikën prapë. Burrë i poshtër paska qenë. U bë një herë me ne, pastaj tradhtoi. Hë, tha kryetari i Lajthizës se ka bërë një letër dhe kërkon falje.

RRAPOJA: (*Pështyn*) Tfu! Maskarai! Le të vijë, le të vijë, se ia tregoj unë faljen!

MEMOJA: Këshillat duhet t'i forcojmë edhe më shumë, Zylo. Vetëm ato duhet të nijhen në fshatra si qeveri. Këshillat duhet t'i bindin njerëzit për drejtësinë e luftës sonë. Ato duhet të nxjerrin partizanë, vullnetarë. Ushtria jonë po rritet. Batalionet po kalojnë në brigada. Me se do të mbushen këto brigata? Ja, me vullnetarët që do të pregatisin këshillat... (*Shtrohet sofra me raki dhe meze*) Oh, po ç'e deshe rakinë, o Zylo?

XHEMALI: E tepërt, për nder, e tepërt!

XHA JASHOJA: Ç'e tepërt, more, ju bëtë gjithë atë muhabet dhe mos pini një kupë? Llaf është ai? (*Vijnë Fatja, Maku*).

ATA: Mirëmbërëma!

XHA JASHOJA: Bujrum, uluni! (*Zënë vend*) Mirë se na urdhëruat! Me një çlirim të shpejtë. Theftë hundët dushmani! Gëzuar! (*Pijnë*)

TË TJERËT: Gëzuar! Të lumtë goja! (*Pijnë*)

XHA JASHOJA: Ky gjermani, more Rrapo, shumë katil qenka. Ky vraka ç'gjeka përpara.

RRAPOJA: Nuk e ka edhe aq të gjatë, jo!

XHA JASHOJA: Të gjatë, xhanëm, nuk e ka ore jo!

ZYLOJA: (*Merr filxhanin*) Ju paçim, or byrazerë! Të paçim, or komandant! Të paçim, Memo; ju paçim të gjithëve e me një liri të shpejtë. Brom, komandantri Rrapo!

RRAPOJA: (*Ngrē filxhanin*) Brom e mira! (*Pauzē*).

XHA JASHOJA: Andej nga fronti i rusëve gjer ku është ky qerrata gjerman, ore Rrapo?

RRAPOJA: (*Vështron Memon, përtypet*) Po ja... andej po ikin, po digjet e po dreqoset (*Kollitet.*)

XHEMALI: Rusët, xha Jasho, e nxorën nga toka e tyre gjermanin. Tani luftojnë në Poloni. Fronti gjithnjë shtyhet dhe ngushtohet në drejtim të Gjermanisë. Të gjithë popujt janë ngritur në këmbë.

XHA JASHOJA: Hajde, ore Stalin, hajde! U dogje, or i shkretë, por e bëre tënden! I vure përpara katalët.

ZYLOJA: Baba, do të ngresh një dolli?

XHA JASHOJA: Po mbushma, o Zylgan, mbushma.

ZYLOJA: Të mbushur e ke.

XHA JASHOJA: Shëndeti i yt, o Rrapo! Rrofsh e qofsh. Të lumshin këmbët që na urdhërove! (*Pijnē. Zyloja ua mbush*) Shëndeti yt, Memo, të dëgjofsha zënë e mirë. (*Pijnē*) Shëndeti yt, o Xhemal! U bëftë ç'na do e bardha zemër! (*Pijnē*) Po mbushma, or Zylgan, mbushma! (*Zyloja ia mbush*)

RRAPOJA: Gjak e dhjamë!

XHA JASHOJA: (*Me filxhanin të mbushur i drejtohet Rrapos*) Brom, te ti më tha zemra të ndalem. (*Pijnē*)

RRAPOJA: Me shëndet! (*Në oborr dëgjohen zëra. Del Zyloja*)

ZËRI I ZYLOS: O, hajde, Hodo Allamani, hajde.

HODOJA: (*Duke hyrë*) Ju bëftë mirë.

XHA JASHOJA: Bujrum. (*Hodoja ulet*)

XHEMALI: (*Memos*) Nesër që me natë po nisem për në Vithkuq.

MEMOJA: Më mirë të ishe nisur që sonte.

XHEMALI: E pamundur. Duken dritat e makinës!

MEMOJA: Hë, hë! (*Mendohet*) Zylo!

ZYLOJA: Urdhëro, Memo!

MEMOJA: A ka në fshat nga ata ushtarët e mbetur italjanë?

ZYLOJA: Janë nja katër.

MEMOJA: Mos është ndonjëri shofer?

ZYLOJA: Më duket se është njëri! Enrikoja, më duket.
E kemi këtu afër.

MEMOJA: Zylo, po s'përtove, shko e thirre të vijë.

ZYLOJA: Menjëherë! (*Zyloja del.*)

XHA JASHOJA: Ore, po e harruat fare këtë të shkretë!
(*Tregon gotat*) Hajde, mirë se erdhët!

RRAPOJA: Gëzuar, Jasho!

XHA JASHOJA: A do t'ia marrin një herë?

XHEMALI: Tani e ka radhën kënga. (*Këndoijnë. Vjen Zyloja me Enrikon*)

ENRIKO: (*Hyn*) Mirëmbrëma!

XHA JASHOJA: Hajde, o italian i shkretë, hajde ulu!

ENRIKO: S'ka xhë. Këtu rri una.

XHA JASHOJA: Jo, jo, hajde këtu! (*Enrikoja zë vend*)

RRAPOJA: Këta italianët dinë të pinë verë.

HODOJA: (*I vë shishen përpara*) Ngreje shishen. Është verë e mirë.

ENRIKOJA: Gëzuar! Faleminderit!

XHA JASHOJA: Gëzuar! Vafsh shëndoshë në shtëpinë tënde!

MEMOJA: Si shkoni me punë?

ENRIKO: Shuma mira!

MEMOJA: Mërzitesh?

ENRIKO: Paka.

MEMOJA: A je i kënaqur nga fshatari që të mban?

ENRIKO: Shuma... nuk dija si shpërbleja.

MEMOJA: Populli ynë ka zemër të madhe... Këtë t'ia tregosh nënës sate!

ENRIKO: Patjetra! Kur tē kthehem do t'ia thema.

MEMOJA: Do tē kthehes. Gjermanin do ta mundim.

ENRIKO: Po, po. E drejta fiton pérhera.

MEMOJA: Tamam! Tani dëgjo pse tē thirrëm.

ENRIKO: Urdhëro!

MEMOJA: Di tē ngasësh makinë ti?

ENRIKO: Una mekanik... por edhe vetura ngas una.

MEMOJA: Puna qëndron këtu. Ne u kemi zënë sot gjermanëve dy makina. Ne duam t'i shpiem në Vithkuq. Njëren do ta ngasë ky shoku ynë, (*Tregon Xhemalin*) tjetrën, a ka mundësi ta ngisni ju?

ENRIKO: Po ajo rruga keqa shumë. Unë s'i besoja kalojë andej makinat.

XHEMALI: Ushtria juaj e ka ndërtuar këtë rrugë pér tē shfrytëzuar pyllin... Besoj se makinat gjermane nuk janë më tē këqija se tuajat!

ENRIKO: E provojmë një hera!

XHEMALI: Nesër në orën tre do tē nisemi bashkë.

ENRIKO: Mira!

RRAPOJA: Dhe asnë fjalë pér makinat, se ku vajtën e ç'bënë e tuti kuantë! (*Qeshin.*)

ZYLOJA: Disa tē rinj e tē reja duan tē flasin me ju.

RRAPOJA: Le tē vijnë. (*Zyloja i thërret. Hyjnë disa djem e vajza.*)

ATA: Ju bëftë mirë!

RRAPOJA: Bujrum!

DJALOSHI: Ne duam tē vijmë me partizanët e batalionit tënd, komandanti Rrapo! Duam edhe ne tē luftojmë me ju!

RRAPOJA: Hëm! Që sot hajdeni. (*Hodos.*) Merri në kompaninë tënde! Ju lumtë, djemtë e Rrapos, ju lumtë! (*Vështron vajzat.*) Po këto vajzat?

BALJA: Edhe ne duam tē vijmë me ju. (*Rrapo bëhet gati tē flasë.*)

MEMOJA: (*Ndérhyn.*) Shumë mirë. Ejani së bashku me djemtë. Do të bëheni partizane të mira.

RRAPOJA: Dëgjoni, moj...

MEMOJA: (*E ndérpret*) Shkon i tani e nesër na prisni te shkolla. Atje do të mblidhemi! (*Të rindjtë dalin. Pauzë e nderë.*)

RRAPOJA: (*Kollitet*) Komisar, po na e bën përshesh batalionin!

MEMOJA: (*Përmban zemërimin. Të tjerët kanë prerë bukën*) Në ç'kuptim, përshesh?

RRAPOJA: Në kuptimin e përsheshit! Femra unë nuk dua në batalionin tim. Ata të batalioneve të tjera le të bëjnë ç'të duan. Udha jonë është e vështirë. Jeta jonë është e dreqosur. Femra më ngatërron batalionin!

MEMOJA: Femra është gjysma e shoqërisë! Revolucioni nuk bëhet vetëm për meshkujt dhe as nuk e bëjnë vetëm meshkujt. Femra s'është më pak trime se ti edhe se unë.

RRAPOJA: Sa jam unë në batalion, këmbë femre nuk shkel. Dhe mos më trego mua përralla.

MEMOJA: Vajzat do të vijnë në batalion!

RRAPOJA: Për atë vendos unë!

MEMOJA: (*Ngrë zérin*) Jo ti, po shtabi i batalionit! (*Rrapo pérplas lugën dhe bukën. Vështron Faten.*)

RRAPOJA: Fate, e pështynë Rrapon. E bënë Rrapon lek-kë, Fate! S'i mbeti gjë Rrapos në batalion, vetëm të vijë e t'u mbajë bishtin e fustaneve grave. E dreqosën Rrapon, Fate!

MEMOJA: Rrapo, duhet ta kuptosh se lufta jonë nuk është si lufta e ballistëve, por është demokratike. (*Rrapoja vështron gjatë, pastaj thotë shumë i qetë.*)

RRAPOJA: Unë, djalë, mendoj që ti të kthehesh përsëri në Qarkor. Batalioni ynë nuk ka nevojë për komisar.

MEMOJA: Nuk tē kuptova, Rrapo!

RRAPOJA: S'kam nevojë pér komisar! Komisar jam unë dhe Fatja! (*Rrapoja nxjerr nagantin dhe e ve nē sofér. Edhe Memoja nxjerr nagantin dhe e pérplas nē sofér.*)

MEMOJA: Unë nuk kam ardhur këtu pér mustaqet e bu-kura tē Rrapos dhe tē Fates. Unë kam ardhur këtu tē bëj punën e Partisë dhe do tē dëgjoj zërin e popullit e jo tē bëj kundër popullit! Batalioni nuk është pronë e një njeriu! (*Pa u ndier, Rrapoja ngri-het, merr nagantin, vështron vëngér, pastaj del ngadalë. E ndjekin Fatja dhe Xhodoja. Memoja fillon tē hajë, e pasojnë Hodoja Maku dhe Zyloja. Hesh-tje e nderë.*)

ZYLOJA: Unë i kam fajet që solla ato vajzat.

MEMOJA: Ti nuk ke asnë faj, Zylo! Dhe duhet tē dërgosh edhe vajza tē tjera nē batalion.

ZYLOJA: Po i gjeti nē rrugë ato çupat, i vrou!

XHODOJA: Nuk është dhe aq i egër. Është njeri me orë!
(Largothen.)

XHEMALI: Nuk bëre mirë, Memo. Ti veprove me mënyrën e Rrapos. Po sikur tē kishte ndodhur ndonjë gjë e shëmtuar? Si thamë kur erdhëm nē batalion? Komandanti Rrapo duhet edukuar. Po me se? Me kobure?!

NË KASOLLEN E RRAPOS

Rrapoja këndon një këngë tē vjetër trimërie.

Në mes tē Kolonjës,
në një psar tē shkretë,
fshehur Myftar Labi

me tetëmbëdhjetë.
Miknë të na zhveshin,
miknë të na vrasin,
një nga ne mos mbettë.
Ky Ali Arapi
mblodhi gjithë kazanë,
o burra, o shokë,
Dhoskën na e vranë,
mik me të vërtetë,
një nga ne mos mbettë!

(*Hyn Memoja vështron Rrapon. Pauzë*)

MEMOJA: Vdekje fashizmit, komandant!

RRAPOJA: Hajde, o Memo, hajde!

MEMOJA: Mos je pa qejf kështu?

RRAPOJA: Jo, or Memo, jo. Di unë, se ç'më ka hipur.

MEMOJA: (*Dredh cigare.*) Kohë e keqe.

RRAPOJA: Lëre viranen, lëre! Mirë ishte të qëndronim
në fshat, po ç't'i bësh asaj të flamosure xhade që
është afër. Vijnë e të rrethojnë! (*Pauzë*)

MEMOJA: E di pse erdha?

RRAPOJA: Hë?

MEMOJA: Këto ditë mund të vijnë këtej gjermanët me
Sali Protopapën pér një operacion.

RRAPOJA: Kush ta tha këtë?

MEMOJA: Qarkori më dërgon letër.

RRAPOJA: Habitem! Gjermanët, pas asaj që hëngren në
xhade, s'ma merr mendja se ngjiten përpjetë.

MEMOJA: More, po kjo është e sigurtë, Rrapo. Ata do
të vijnë, por se kur, këtë s'e dimë. (*Pauzë*) Përpara
kësaj gjendjeje, mendoj të bëjmë një organizim më
të saktë të kompanive.

FATJA: (*Rrapos*) Mirë janë kompanitë, Rrapo! (*Memos*)
Lëre këtë muhabet, o komisar!

MEMOJA: Nuk e le, o Fate, jo! Nuk janë mirë! Zëvendës-komandantë nuk ka. Komisarë nuk ka. Skuadërkomandantët ndërrohen përditë. Më teket mua heq njërin, vë tjetrin. Tani të jemi të ndërgjegjshëm... Me një organizim të tillë mund të zbrazësh një dyfek këtu, një dyfek atje, po luftë të vërtetë çlirimtare nuk bën dot. Kemi njerëz të zot, kemi forca, pse të mos vëmë rregull!

FATJA: Sikur ne s'kemi pasur rregull. E si e kemi bërë gjithë këtë luftë?

MEMOJA: Ju lumtë! Keni luftuar! Por duhet ta dish se gjithë telashet e rregullit i ka mbajtur Rrapoja! Ju komandantët e kompanive, edhe për gjënë më të vogël, atë pyesnit. Vërtetë komandanti do pyetur, por edhe ju duhet ta vrissni pak mendjen. (*Rrapoja hesht.*)

FATJA: Nuk është e vërtetë!

RRAPOJA: (*Shfryny*) E vërtetë është! Komisari ka të drejtë! Lesh arapi është batalioni. As ty, as Hodos, as Xhodos dhe as Mak Mokrës nuk ju punon truri fare. Njëqind herë në ditë më zini mua (i përqesh): «Komandanti Rrapo, si ta vë festen: mënjanë apo drejt», «Komandanti Rrapo, të ha bukë me gjizë apo me turshi», Rrapo këtej, Rrapo andej, mëk këtej, mëk andej. (*Thérret*) Haramsëzë! (*Memos*) I ke rënë pikës, Memo. Çorbë është batalioni. Duhet organizuar! (*Fates*) Shko lajmëro komandantët e kompanive për mbledhje.

RRAPOJA: Je komunist ti, Memo?

MEMOJA: (*Buzëqesh*) Të gjithë komisarët komunistë janë!

RRAPOJA: E pra, unë nuk jam, o Memo! Ka huqe Rrapoja. Nxehet e s'di se ç'bën. Eh, more Memo! Rrapoja përgjigjet për gjithë këta njerëz. Vriten, plago-

sen, sëmuren, — Rrapoja vuan. Po asnjeri s'ia sheh dot zemrën Rrapos se si përpëlitet, se si hidhet, se si digjet! Po për cilin digjet zemra e Rrapos, more Memo? Për batalionin digjet! Rrapoja ka vetëm batalionin dhe një djalë te çobenjtë! (*Pauzë.*)

MEMOJA: (*I prekur.*) Rrapo, edhe ti mund të bëhesh komunist.

RRAPOJA: Ka huqe Rrapoja, o Memo, ka huqe!

MEMOJA: Edhe huqet ndreqen. Nuk ka gjë që s'ndreqet po të duash.

RRAPOJA: (*I habitur*) Vërtetë, thua?

MEMOJA: Po si ore. Të gjithë kemi huqe. Po unë, i larë kam qenë? Ehu, sa huqe kam pasur unë!

RRAPOJA: Po ç'i bëre, o Memo?

MEMOJA: I hoqa!

RRAPOJA: I hoqe??

MEMOJA: Po ore, po, i hoqa!

RRAPOJA: Po si?

MEMOJA: Partia m'i hoqi!

RRAPOJA: Si Partia?

MEMOJA: Tamam si ai druvari i mirë që gdhend me së-patë atë drurin e par mendës. Tak një ashkël këtu. Tak një ashkël atje. Tak një ashkël matanë... e kësh-tu me radhë, sa herë që gaboj. Është Partia jonë kjo, o Rrapo, Partia e fukarenjve. (*Pas pak*) Ja, më thuaj ti, ç'pasuri ke?

RRAPOJA: E ç'pasuri kam unë i varfëri, o Memo. Një djalë atje te çobenjtë e një pushkë në krah. Këtë ka pasur gjithmonë Rrapoja, një copë misërnike dhe pushkën në krah.

MEMOJA: E shikon pra! Prandaj të thashë që edhe ti mund të bëhesh komunist. Është Partia jote kjo, Rrapo Tabani! Se mos është e bejlerëve dhe aga-llarëve. Ata e kanë halë në sy. Ata duan ta zhdukin.

RRAPOJA: Bre, bre!

MEMOJA: E rëndësishme është të dish përse të luftosh.

Të kesh një udhëheqje të dalë nga gjiri i popullit. Dridhe. (*I jep kutinë.*) Të kam dëgjuar disa herë që këndon këngë të vjetra për ata kapedanët si Tafili, Zyliftari, Çerçizi. Kanë qenë trima vërtet.

RRAPOJA: Të merrnin gjak në vetull!

MEMOJA: Ne gjithmonë kemi luftuar po ç'e do, s'kemi fituar! Pse do të thuash ti? Sepse s'kishim udhëheqje. Kurse sot është ndryshe. Është tjetër kohë.

RRAPOJA: Vërtetë, ashtu është! Tjetër kohë, koha e komisarëve.

MEMOJA: Koha e Partisë. Dhe kjo kohë s'do të ketë mbarim. Edhe nesër kur të çlirohemi, edhe pasnesër, gjer në komunizëm... Ti, Rrapo, je një kapedan trim. Mirëpo nuk je nga ata të parët. Je komandant i batalionit «Shkrepëtima». Ky batalion është i inkluadruar në Ushtrinë Nacionalçlirimtare, që ka një shtab që udhëhiqet nga Partia. Prandaj ne s'mund të bëjmë me kokën tonë. Ne s'jemi çeta kaçakësh. Ne duhet ta forcojmë edhe më tej për disiplinën dhe rregullin. Prandaj duhet ta riorganizojmë batalionin, Rrapo!

RRAPOJA: Hajde, o komisar, hajde! Gdhende këtë kokë gdhë të Rrapo Tabanit, gdhende! (*Memoja qesh.*) Bëji kurs politik Rrapos ti, bëji, se ka huqe Rrapoja!

MEMOJA: Kurs politik po bën Xhemali që e mbajtën atje në shtab dhe akoma s'është kthyer! Ne vetëm po bisedojmë.

RRAPOJA: Ke hak ti, mor vëlla, se nuk ke huqe si unë.

MEMOJA: Kush tha?

RRAPOJA: Unë them, ajo duket.

MEMOJA: Nuk është ashtu.

RRAPOJA: (*Hutohet.*) S'po marr vesh...

MEMOJA: Dëgjo, Rrapo. Po të kallëzoj një sekret, por ama, mos ia thuaj njeriu.

RRAPOJA: Mos ki merak ti.

MEMOJA: Për atë punë e kobures që të nxora ty, atje në shtëpinë e Zylos, më hoqën një dajak të mirë!

RRAPOJA: Ik more! Po kush?

MEMOJA: Partia.

RRAPOJA: Partia?! Po pse, bre... Tani, të flasim të drejtën, aty unë e kisha gabimin!

MEMOJA: Duhet të shtröhesh këmbëkryq me njerëzit, më thanë, duhet t'i bindësh ata e jo të nxjerrësh koburen!

RRAPOJA: (*Pasi mendohet pak*) Hajde, Parti, hajde! T'u bëftë kurban Rrapoja ty! (*Vijnë Alma me Nurkën*)

TË DY: Vdekje fashizmit!

MEMOJA: Liri popullit!

RRAPOJA: (*Vështron Memon.*) Liri popullit, trima!

NURKA: Na thanë, ju kërkon komisari.

MEMOJA: E dini si është puna? Celula ka vendosur të ngrihet një kurs kundër analfabetizmit. Me drejtimin do të merreni ju, shoqja Alma Borova. Kurse Nurka, si intendent, do të gjejë fletore dhe lapsa. Kursi të fillojë sa më shpejt.

NURKA: Sa copë?

MEMOJA: Sa më shumë, më mirë. Një laps do ta ndajmë në tresh. (*I jep Almës një letër*) Merre. Kjo është lista e analfabetëve. (*Rrapoja vështron dhe hesht.*)

ALMA: Po unë s'kam qenë ndonjëherë mësuese.

MEMOJA: As Rrapoja s'ka qenë komandant, as unë s'kam qenë ndonjëherë komisar, por u bëmë!

NURKA: As Nurka s'ka qenë ndonjëherë intendent! (*Qeshin*)

MEMOJA: Lajmëroni që tani ata që keni në listë.

ALMA: Ku më dëgjojnë mua.

MEMOJA: Urdhër nga shtabi. Shkoni. (*Ata dalin.*)

RRAPOJA: Demek shkollë.

MEMOJA: Shkollë, o Rrapo! Gati gjysma e batalionit s'dinë shkrim e këndim.

RRAPOJA: Demek, tani s'mbetet gjë tjetër veçse t'i bie asaj... si i thonë, more... pjanos?

MEMOJA: Ti, Rrapo, di shkrim e këndim?

RRAPOJA: Ehu, me gjepura nuk merret Rrapoja! Shkrim e këndim! Sikur na qenka ndonjë punë e madhe shkrimi.

MEMOJA: Nesër do të kemi të bëjmë me zyra dhe ministria, Rrapo. Ne do të drejtojmë shtetin. Do të kemi të bëjmë me njerëzit e lirë. Do të zgjidhim punët dhe hallet e tyre. A do mund të drejtojmë pa ditur ABC-në?

RRAPOJA: (*Mendohet. Thith cigaren.*) Demek, do të drejtojmë ministriira. (*Qesh. Edhe Memoja qesh.*)

MEMOJA: Sot na duket si çudi, por atëherë do të jetë një gjë e zakonshme. Kur të vi unë e ta gjej Rrapon duke firmosur... (*Rrapoja ia shkrep të qeshurit. E zë kolla*)

RRAPOJA: Ku të vete mendja, more komisar. (*Qesh me të madhe. Hyn Hodoja. Vështron Rrapon që qesh dhe habitet.*) E, more komisar, të marrtë e mira. Na bëre të qeshim me lot. Qeshim, o Hodo, qeshim!

HODOJA: More, po ajo çupa qenka e lojtur!

RRAPOJA: Cila?

HODOJA: Ajo, Alma. Më tha që të shkoj nesër në shkollë. Amani, ore vëllezër, a jemi ne për shkollë?

RRAPOJA: (*Vështron serioz Hodon, pastaj Memon.*) Ne jemi për shkollë, po kush more, borgjezi?

HODOJA: Po unë...

RRAPOJA: Mbylle! Nesër do të drejtojmë shtetin. Me bilmezë nuk drejtohet shteti. Të mësosh që të të pëlcasë koka.

HODOJA: Edhe ti, o Rrapo, nuk di shkrim e këndim!

RRAPOJA: Kush more? Unë s'ditkam shkrim e këndim?
Unë të lexoj se ç'ke të shkruar ti në kapakët e kokës, jo mos të lexoj një copë letër. (*Qeshin. Dalin. Në shesh Nurka u shpërndan fletore partizanëve. I jep Hodos.*)

NURKA: Merre.

HODOJA: Ç'është?

NURKA: Tefter për kursin e analfabetizmit.

HODOJA: Pse ore, tani në pleqëri?

NURKA: Duam të të bëjmë plak me shkollë.

HODOJA: Ik, o qërohu! (*Largohet. Nurka ia lë në dorë fletoren komandantit Rrapo*)

RRAPOJA: Demek, ma dha Nurka! (*Kollitet*) E, more Memo, edhe Rrapoja nuk di shkrim e këndim. E ku të mësonte Rrapoja më përpara. Nuk e linte burgjezi Rrapon të mësonte. Them edhe unë të mësoj shkrim e këndim. E kam të vështirë, po do ta provoj njëherë. (*Memoja mezi mban të qeshurën.*) Ti do të më mësosh mua, të paktën sa të hedh fir-mën. (*I zgjat Memos fletoren*).

MEMOJA: (*Serioz*) Shko tek Alma, ajo është mësuese në shkollë.

RRAPOJA: Ehu! Me femra nuk mësoj unë. Një piçiruke do të më mësojë mua si bëhen gërmat??

MEMOJA: Të mëson më mirë se unë ajo.

RRAPOJA: Jo, or, jo. Rrapon vetëm komisari mund ta mësojë!

MEMOJA: Dëgjo...

RRAPOJA: Mjaft! U vendos kjo! (*Rrapoja largohet. Memoja buzëqesh.*)

NË NJË SHESH

RRAPOJA: Hajde, o djemtë e Rrapos, hajde mësoni! Bur-gjezit ne do t'ia kalojmë. Tutkunë janë burgjezët, mezi u hyjnë në kokë germat. Jepini, djema, jepini! (*Partizanët i mblidhen Rrapos*). Ju të rintjtë keni qëlluar:

BALJA: Kemi qëlluar.

RRAPOJA: S'ma merr mendja.

NAFIJA: Na kanë mësuar shokët e njësitit.

RRAPOJA: Hë, më ju lumtë! Po me mitraloz?

BALJA: Me mitraloz jo.

RRAPOJA: Po në qoftë se vritet mitralieri, po të jesh afër, çfarë do të bësh? (*Heshtje*) E shikon? Prandaj duhet mësuar edhe mitralozi.

RRAPOJA: Zarik, sille dykëmbëshin! Vëre këtu, Zarik! Ja, ky është mitralozi. Ky shoku do t'ju tregojë për të. Ka qenë roje finance dhe ia di të gjitha kyçet. (*Rrapoja largohet*).

ZARIKU: (*Nafijes*) Provoje një herë ta ngrësh ti.

NAFIJA: (*E provon*) Ua, sa i rëndë që është.

ZARIKU: Ta pret mendja që është i rëndë, ç'kujtove ti? (*Fillon zërthimin e mitralozit*) Ah, more vëlla, s'është punë për çupat kjo. Nejse! Kjo këtu është tyta!... Kjo është këmbëza e shkrepjes... Këtu bren-da është gjilpëra... Po edhe unë ç'lodhem me ju. Ju nuk e mbani dot, jo ta përdorni... nejse...

BALJA: Kushedi, mbase e përdorim, more shok.

ZARIKU: Vërtet? Më bëhet qejfi. Paskeni shumë besim në veten tuaj, moj çupë.

BALJA: Patjetër që duhet të kem.

ZARIKU: Po, po... duhet... duhet, duhet! Kjo është qyta... E di ç'keni ju? Një herë tjetër se kam punë sot. (*Vajzat pezmatohen*) Një herë tjetër, një herë tje-

tër... (*Ato ikin*) Dosat e dreqit. Duan që të mësojnë mitralozin, pa le. Pritni, pritni edhe pak sa të fillojë bora, pa llafosemi bashkë. Atëherë do të kujtoni oxhakun e shtëpisë. Eh, neje!... (*Merr dykëm-bëshin dhe largohet. Afrohet komisari me Mak Mokrën*).

MAKU: Shoku komisar!

MEMOJA: E, Mak Mokra. (*I hedh krahun.*) Çfarë ke?

MAKU: (*I jep një shami.*) Merri!

MEMOJA: C'janë këto?

MAKU: Fishekë për atë goldin tënd! (*Memoja buzëqesh*)
Kam vënë re se ke shumë pak. Kësaj marke mezi i gjinden. Unë kërkova dhe gjeta këto. Pak janë, po mbapse do të gjejmë edhe të tjera.

MEMOJA: Të falem nderit, Mak Mokra. (*Me shaka.*) Po mirë, sa të kushtojnë?

MAKU: Nuk i shes me para.

MEMOJA: Po me çfarë?

MAKU: Me libra!

MEMOJA: Me libra? Po ty nuk të lë Rrapoja të këndosh libra!

MAKU: Ehë! Tani ka ndryshuar. Bile një ditë më tha t'i këndoja diçka për Skënderbeun! (*Memoja qesh*)
E mora me mend, se duhet t'i kishe mbajtur ndonjë konferencë ti, o shoku komisar! (*Qeshin*)

MEMOJA: Dakord, Mak. (*Nxjerr nga çanta një libër*)
Merre!

MAKU: (*E merr dhe vështron.*) Qenka i shpuar.

MEMOJA: E ka pasur një shoku im! Plumbi i armikut shpoi librin dhe zemrën!

MAKU: Mos more!

MEMOJA: Flet për Leninin dhe Stalinin. Këndoje!

MAKU: Faleminderit, shoku komisar!

(*Dëgjohet boria e alarmit. Partizanët vihen në lëvizje.*)

BATALIONI PARTIZAN

Bie borë. Fryn tufani. Në krye të kolonës kanë qëndruar Rrapoja dhe komisari.

RRAPOJA: Në sheshet e Gur-Kusarit do të kemi punë.

MEMOJA: Pse?

RRAPOJA: Do të hapim borën që ka mbushur kolibet e vleħeve.

MEMOJA: Nisim disa partizanë pérpara.

RRAPOJA: (*Mendohet*) Dërgojmë Zarikun me disa shokë. Ai e njeh mirë këtë vend. (*Fates*) O Fate!

FATJA: Urdħero, komandant!

RRAPOJA: Më thirr Zarikun.

FATJA: (*Thérret*) O Zarik! Të kérkon komandanti. (*Zariku afrohet te Rrapoja*)

RRAPOJA: Mendoj të marrësh ca partizanë e të shkosh në sheshet e Gur-Kusarit. Gjersa të vijë batalioni, ju pastroni borën dhe bëni gati drurët pér zjarrin.

ZARIKU: (*Pas pak*) Nuk e ndiej veten mirë.

RRAPOJA: Si?

ZARIKU: Në përgjithësi, s'ka pérse të shkojmë me kaq nxitim. Kur të arrije batalioni, le t'i pastrojë. (*Rrapoja don të bërtasë, po përbahet*)

RRAPOJA: Zarik, duhet të shkosh, xhani i Rrapos.

MEMOJA: Urdħeri eshtë urdhér!

ZARIKU: (*Ngrē jakēn*) Nuk mund të shkoj.

RRAPOJA: (*Vē dorēn nē strehē*) Lepe?

ZARIKU: Nuk jam nē gjendje.

RRAPOJA: Zarik. Të kujtohet kur m'u dorëzove dhe m'u lute të tē mbaja! Unë thashë se ti do të bħeshe njeri i mirë dhe tē mbajta, po ti po e gënjen Rrapon. Po Rrapoja, para se tē vemi nē sheshet, do tē t'i nxjerrë dhembét si Mazllém Bylykut dhe do tē

të hedhë në borë, do të të japë një shqelm dhe do
të lëshojë të të hanë ujqërit e Gur-Kusarit. Nuk
tallet Rrapoja! (Pauzë)

ZARIKU: Përse bërtet, o komandant! Jam pa qejf! Za-
ten, kështu silleni gjithmonë me mua ju.

RRAPOJA: Sillem se më ke vrarë babanë!

ZARIKU: Jo, babanë por...

RRAPOJA: Atëherë ç'më dërdëllit? Nuk të vjen turp nga
ato çupat që i kanë këmbët e enjtura dhe nuk an-
kohen! Gjithmonë me grindje e bën punën!

ZARIKU: (Manevron) Mirë, po shkoj, po jam pa qejf.
(Rrapoja s'përgjigjet. Zariku largohet të mbledhë
shokët)

MEMOJA: Nuk më pëlqen ky njeri.

FATJA: (Nurkës me zë të ulët) More, po ç'ka ky Zariku?

NURKA: Fate vëllai, ka ndryshuar puna. Operacioni, bo-
ra, rregulli i madh... smirë ka.

FATJA: Të kujtohet kur erdhi?

NURKA: Ojna, marifete.

FATJA: Sonte, mbase, mund të jetë me të vërtetë pa qejf.

NURKA: Unë, Nurka, o Fate vëllai, nuk i besoj.

ZARIKU: (Mënjanë) Të poshtërit! M'i prishën planet!

(Vjen një grup tjetër)

XHEMALI: (Italianit) Enriko, andej nga ju ka dimër të
tillë?

ENRIKO: Në veri po, ja si këtu.

XHEMALI: Dhe andej nga ju ka partizanë.

ENRIKO: Nuk e di.

XHEMALI: Ka Enriko, ka. Duçja u rrëzua, po fashizmi
akoma nuk është rrëzuar.

HODOJA: Ç'na bëtë ju italianët me këtë djall fashizmi.

Ku e gjetët këtë farë të keqe që e mbollët, xhanëm!

(Enriko s'përgjigjet)

XHEMALI: Fara ishte e borgjezisë, ajo e mbolli.

MAKU: Me ushqimin si do t'ia bëjmë? Në behar bëhej si bëhej se ishin vëllehët, kurse tani atje ka vetëm kolibe të zbrazura.

XHODOJA: Mos u bëj merak, kanë menduar Rrapoja dhe Memoja. (*Afrohen vajzat*) Mbahuni edhe pak, motra, mbahuni.

ALMA: Sa rrugë të vështira!

XHODOJA: Dimri i Gur-Kusarit është i egër, i egërson edhe rrugët.

BALJA: Kemi edhe shumë?

XHODOJA: Pothuajse vajtëm. (*Borë, furtunë. Afrohet Rrapoja*)

RRAPOJA: E, moj çupa, a u lodhët?

ALMA: Pak, komandant!

RRAPOJA: Moj, po u këputa unë, jo ju. (*I afrohet Nafijes*) Si je Nefo? Më mirë?

NAFIJA: Çka.

RRAPOJA: Po sikur të qëndrosh këtu me Xhodon dhe shoqet. Është një kolibe e prishur. Çlodhuni dhe nesër ngjituni lart.

NAFIJA: Në asnjë mënyrë, shoku komandant. Nuk ndahem nga batalioni!

RRAPOJA: Nuk mund të ecësh dot, moj xhane e Rrapos. I ke këmbët e enjtura.

NAFIJA: Komandant! Gjallë a vdekur, unë nuk shkëputtem nga kolona partizane.

RRAPOJA: E ku je, o trimja e Rrapos! Na, vishi këto çorape. Janë prej lesi dhe të ngrohin shpirtin.

NAFIJA: Jo nuk i dua, shoku komandant. Nuk i dua!

RRAPOJA: Merri! Të urdhëroj! (*Rrapoja heq çorapet dhe ia jep asaj. Për vete mbështjell këmbët me shami*) Tani përpara! Vetëm përpara. Mbahuni dhe pak, o partizanët e Rrapos! (*Kolona vazhdon marshimin*).

PARTIZANËT RRETH ZJARREVE

Një grup partizanësh të vendosur në formë harku këndoijnë. Ndriçohen vetëm nga drita e zjarrit. Në një qoshe, Rrapoja dhe Memoja dëgjojnë.

MEMOJA: Borë dhe këngë.

RRAPOJA: Kënga të çlodh, o Memo (*Dëgjon*) I kam pasur qejf këto të shkreta këngë. Edhe vallet. Eh, ikën ato kohëra! Heq një valle tjetër Rrapoja tanë. Valle buzë xhadesë, nën krismën e mitralozave. Lëviz Rrapoja nëpër male, lëviz...

XHEMALI: (*Pasi mbaron kënga*) Na fol një fjalë, o Nurkë!

NURKA: Dale të më shkrijnë, se më kanë ngrirë të gjitha fjalët në gjoks. (*Qeshin*)

XHEMALI: Nurkë, ti si intendent që je, dëhet të kesh kujdes që kur të vijë Sali Protopapa këtej, t'i pre-gatisësh gjellë të mirë.

XHODOJA: Thonë se është llupës i madh. Në një darkë te Bamka kishte ngrënë një dash të téré.

XHEMALI: Edhe ne një dash të pjekur do t'i japim. Apo jo, Nurkë? (*Qeshin*)

FATJA: Ore, sa të ngrohta që ishin ato gropat me borë që kanë hapur partizanët e Mevlanic.

XHODOJA: Vërtet. Sikur t'i bënim edhe nga një çati të vogël, do të ishim më mirë se në shtëpi.

MAKU: Tamam si eskimezët.

HODOJA: C'janë këta, o Mak.

MAKU: Kam kënduar në një libër. Janë ca fise që jetojnë në borë.

XHEMALI: Jetojnë andej nga Poli i Veriut. Ushqehen me mish e peshk.

HODOJA: Po mirë, ka ndonjë lëvizje partizane andej?

XHEMALI: Është popull i pazhvilluar.

HODOJA: Të shkretët!

XHEMALI: Janë njerëz primitivë.

HODOJA: Ç'na hipën në kokë këta eskimezët sot.

MAKU: U mërzita së mbajturi në gojë Sali Protopapën, prandaj.

NURKA: Vërtet që u mërzitëm.

HODOJA: Njëqind herë janë më të mirë ata esqimezët se sa ai viran Sali!

NURKA: S'do mend ajo punë! (*Largo het. Qeshin*)

XHEMALI: Hajde Enriko, na këndo një këngë.

ENRIKO: Shokët mungon... vetë zë prishur. (*Bën disa vokalizma. Partizanët qeshin*)

XHEMALI: Enriko, atë këngën «Bandiera Rosa».

ENRIKO: Nuk di mirë... betohem...

HODOJA: Hajde, o taljan, hajde, se ta mbajmë ne. (*Partizanët qeshin*.)

ENRIKO: Mira. Po filloj... (*Këndo jnë këngën «Bandiera Rosa»*)

RRAPOJA: (*Afrohet te zjarri*) Gëzuar, trima!

ATA: Gëzuar, komandant! (*I bëjnë vend*.)

MEMOJA: U lodhët, moj shoqe.

BALJA: Pak.

MEMOJA: Si e ndien veten, Nafije?

NAFIJA: Jam më mirë tani.

RRAPOJA: Hajde, kokëforta e Rrapos, hajde. S'deshi që s'deshi të qëndronte poshtë. Njësoj si kokën time e ka. (*Qeshin*) Këndoni, djema e vajza, këndoni! Dëgjuam që u vete kënga.

XHEMALI: Mezi i mbushëm mendjen Enrikos të na këndonte.

RRAPOJA: Pse?

XHEMALI: Thotë se e ka zërin të prishur.

RRAPOJA: Se mos do ta shesim ne. (*Qeshin*) Edhe unë

kam kënduar e hequr valle nëpër dasma. I ri kam qenë, i gjëzuar po, i krisur po. Eh, more djema, një okë raki e mirrja dhe e ngrija si bardhak me ujë gër-gër në gurmaz dhe kokën e këmbët në rregull. Bëhesha për qejf, skuqesha dhe në tepsi mund të hidhja valle, për nder. (*Qeshin*) A keni ngrohtë në ato gropat e borës?

XHODOJA: Shumë ngrohtë, komandant.

HODOJA: Tamam si në pallat. (*Qeshin*)

RRAPOJA: Kurse Zariku s'desh të vinte t'i bënte. (*Vështron*) Ore, po ku është Zariku?

XHEMALI: Mos jetë në zjarret e tjera.

RRAPOJA: Mevlan, shko thirre.

MEVLANI: Si urdhëron, komandant!

RRAPOJA: (*Vështron Hodon që mban dorën në faqe*) Po ti, Hodo, ç'pate?

HODOJA: Lëre, o komandant, lëre.

XHODOJA: I dhemb dhëmballa, o komandant. Iu ka fryrë si togar.

RRAPOJA: Pa hajde, këtu. (*Hodoja afrohet.*) Hape gojën.

HODOJA: Mbase nuk është nevoja ta nxjerrim.

RRAPOJA: Hape, ore, të them.

HODOJA: Për nder më pushoi, o komandant.

RRAPOJA: Hajde, hajde, se ashtu të duket nga frika. Vëre kokën këtu në gjurin tim.

HODOJA: Komandant...

RRAPOJA: Hape. (*Vështron*) Hm! Ç'dhëmballë mushke që më paske! (*Nxjerr darën*) Bëhu burrë, Hodo.

MEMOJA: (*E ndalon*) Rrapo!

RRAPOJA: Hë!

MEMOJA: Lëre. Ka rrezik të infektohet dhe na hap avaze.

RRAPOJA: (*E vështron*) Dëgjo, Memo! Po e mbaj vetëm për vete.

MEMOJA: Pse, ore komandant, prej hekuri i ke dhëmbët
ti e s'të infektohen? Hë!

RRAPOJA: Ta dorëzoj?

MEMOJA. Po.

RRAPOJA: Merre! (*I dorëzon darën. Partizanët lehtë-sohen. Vjen Nurka.*)

NURKA: (*Duke hyrë*) Komandanti Rrapo, po ngjitet xha Jashoja!

RRAPOJA: Vërtet! (*Lëvizje e përgjithshme. Vjen Jashoja me Zylon.*)

XHA JASHOJA: Vdekje fashizmit, trimat e xha Jashos!

PARTIZANË: Liri popullit! (*Përshëndeten*)

RRAPOJA: Po ku je, o Jasho, t'u mbylltë?

XHA JASHOJA: Këtu në batalionin tënd jam, o Rrapo, t'u haptë!

MEMOJA: Si mbahesh, xha Jasho?

XHA JASHOJA: Si stralli, o komisar i xhaxhait.

RRAPOJA: Në këtë qamet u ngjite, o Jasho?

XHA JASHOJA: U ngjita se s'bën, o Rrapo. Ju solla bukë. I thashë Zylos, bëj gati mushkën e të ngjitemi. Djemtë e xhaxhait do të jenë keq me bukën. Pse, ore, llafë eshtë ai? Ne të hamë dhe ju, që po kaca-fyteni me dushmanin, të rrini pa ngrënë.

MEMOJA: Bëre mirë, xha Jasho. Jemi ca shtrënguar përbukë këto ditë.

XHA JASHOJA: Po nuk e sheh ç'dimër po bën, mor bir?

RRAPOJA: Po tjetër ç'kemi andej poshtë, Jasho?

XHA JASHOJA: Hajde, o Rrapo, hajde, ç'qyfyre kanë dalë për ju andej.

RRAPOJA: Vërtet?

XHA JASHOJA: Na mbytën ballistët llaka-llaka gjithë ditën. (*Përqesh*) «Hë more, ku i keni partizanët? Hë, hë, u zhdukën si kripa në ujë. Gjysma janë

shpérndarë gërxheve, gjysma kanë ngordhur grykave të Gur-Kusarit. Ai Rrapo mustaqeja me atë komisarin kanë vrarë veten.» Grini sallatë ju, grini, — thoshja me veten time unë. U merrni pleshtat atyre. Hipni këtu të shikoni Stambollin! (*Qeshin*)

RRAPOJA: Edhe pak, Jasho, dhe do të derdhemi në luginë e do t'ua tregojmë atyre lapanjozëve cilët do të shuhën dhe cilët do të vrasin veten!

MEMOJA: Ne mund të bëjmë edhe një sulm të papritur nëpër fshatrat e luginës.

XHEMALI: Banorët do të marrin zemër dhe gënjeshtrat e armikut nuk do të pijnë ujë.

RRAPOJA: Ç'kisha qejf për një tërsëllimë të tillë.

XHA JASHOJA: Do ti, o komisar, që Zyloja, për inat të tyre, solli edhe disa vullnetarë të tjera.

MEMOJA: Vërtet! (*Hyn Zyloja*)

ZYLOJA: Bile kam edhe një letër nga shtabi. (*Ia jep Rrapos. Ai e merr, e shikon, pastaj ia jep Memos*).

RRAPOJA: Lexoje ti, o komisar! (*Partizanët qeshin*.)

MEMOJA: (*E merr dhe e lexon*) Janë nisur, Rrapo!

RRAPOJA: Fate, jep alarmin. Folu partizanëve, Memo. (*Dëgjohet boria e alarmit. Partizanët preqatiten për udhë. Grumbullohen rreth zjarrit. Komisari mban një fjalim*)

MEMOJA: Shokë! Në Bujazë, Partia po formon një brigadë të re. Drejt saj janë nisur forca të mëdha gjermano-balliste nën komandën e majorit Hans Binckop. Ne duhet ta mbrojmë. Këto janë përpëlitjet e fundit të bishës së plagosur për vdekje. Me këtë bishë do të kemi akoma telashe gjersa të japë shpirt. Shumë herë do të ngrihem si sonte, të lodhur, me këmbë të enjtura, për t'u vënë shpatullat maleve tonë që armiku të mos kapërcejë! Që armiku të mos shuajë asnjë shkëndijë të zjarrit të madh të lirisë dhe

të revolucionit, ne do të luftojmë gjer në fund. Armiku nuk do të kalojë. Brigada e re, atje në oaze, do të formohet. Do të formohen edhe brigada të tjera. Armiku kurrë s'do të mund t'i ndalojë. (*Pauzë*) Në krah të djathtë kemi partizanët e batalionit të Gorës, kurse nga Guri i Prerë janë ata të batalionit «Tomori». Ne do të bëjmë të pamundurën që grykat tonë të mos kapërcehen. Ata që do të futen atje, do të gjejnë vdekjen në mes të shkëmbinjve dhe do të mbulohen me qefinin e bardhë të borës.

PARTIZANËT: Vdekje okupatorit! (*Partizanët ngrenë lart pushkët. Bora vazhdon të bjerë ngadalë*)

MEVLANI: (*Vjen duke rendur*) Komandanti Rrapo! Zariku nuk gjendet.

RRAPOJA: Si?!

MEVLANI: Ka dezertuar! (*Heshtje*)

RRAPOJA: I poshtri! (*Pas pak.*) Mevlani, merr disa partizanë e bjeri prapa. Shpejt!

MEVLANI: Ika.

RRAPOJA: Zylo, merr njësitin e fshatit dhe mbyllja shtigjet.

ZYLOJA: Si urdhëron, komandanti Rrapo!

RRAPOJA: Me këto duar do t'i nxjerr shpirtin çapaçulit të çapaçulëve!

MBLEDHJE SHTABI

Rrapoja vjen vërdallë i shqetësuar. Nuk i zë vendi vend. Pret lajme për Zarikun.

RRAPOJA: Akoma s'është kthyer Mevlani?

FATJA: Akoma!

RRAPOJA: Ndonjë haber s'ka dërguar?

FATJA: Jo, komandant!

RRAPOJA: Po ndonjë korrier nga Zyloja, s'ka ardhur?

FATJA: Gjer tani asnje, komandant! (*Pauzē*)

RRAPOJA: E, more Zarik, more Zarik! (*Pauzē*)

XHODOJA: Po tē mos e zémë, ai do t'u tregojë atyre...

FATJA: E çfarë do t'u tregojë?

MAKU: Që do tē zémë grykat e Gur-Kusarit.

FATJA: E pastaj?

HODOJA: Pastaj ai Sali qeni, që është sa i egër aq edhe i poshtër, ia ka marrë dorën luftimit nëpër grykat e maleve.

XHODOJA: Bandit dhe hajdut i regjur është, por e njeh vendin me pëllëmbë.

FATJA: Ore, po grykat e Gur-Kusarit i di kushdo, por si do t'i zemë ato gryka, nuk e di njeri.

MAKU: Mbase Zariku di më shumë... (*Pauzē*)

XHEMALI: Çfarëdo që t'u ketë thënë Zariku, ne duhet tē gozhdo hemi në grykat e Gur-Kusarit. Asnjë hap prapa. Këtë e kanë tē gjithë tē qartë. Bile do tē kundërsulmojmë.

MEMOJA: Po, do tē kundërsulmojmë. Vetëm se duhet tē mbajmë disa partizanë rezervë pér çdo tē papritur. E përqëndroi zjarrin armiku në një sektor, kjo rezervë i del nga prapa, e rrethon e, në befasi, i hidhet përsipër.

RRAPOJA: Po nuk kam, o xhani i Rrapos, aq forca sa t'i ndaj si qimet e qerozit! (*Nga jashtë dëgjohen zerra, «Komandanti Rrapo, po vjen Mevlani!» Të gjithë shtangen.*)

MEVLANI: (*Hyn*) Shoku komandant... E kërkuaam gjithandej, po nuk e gjetëm. Shkuam gjer te tre plepat. Më tutje ishin gjermanët!

RRAPOJA: I poshtri! (*Pauzē*) Xhodo!

XHODOJA: Urdhëro, komandant!

RRAPOJA: Shko thuaj Besnikut tē zgjedhë nja katér-pesë shokë që ecin shpejt.

MEMOJA: Ç'ke ndér mend tē bësh, Rrapo?

RRAPOJA: Do tē nisem vetë. Do tē futem nē mes tē gjermanëve, do ta gjej qenin e do t'ia shkul dhëmbët dezertorit!

MEMOJA: Nuk bën, Rrapo. Do tē dërgojmë tē tjerë!

RRAPOJA: Kthehem shpejt. Je ti këtu!

XHEMALI: Komandanti nuk duhet ta lërë batalionin dhe tē ndjekë një dezertor tē poshtër, një palaço.
(Pauzë)

RRAPOJA: Mirë. Nuk dua asnjeri. Po shkoj ta kap vetë qenin e qenit!

MEMOJA: (E zë pér krah) S'ke ku shkon!

RRAPOJA: Lëshomë!

MEMOJA: Nuk tē lëshoj.

RRAPOJA: (Bërtet) Lëshomë, tē them.

MEMOJA: Rrapo, nē qoftë se ti nisesh, unë do ta shpie këtë çështje gjer nē Qarkor. Mendohu pak. Jemi përpara betejës.

RRAPOJA: Demek, më mirë kështu thua ti?

MEMOJA: Zariku nuk ka ku tē futet. Prapë nē dorën tonë do tē bjerë...

RRAPOJA: Ç'e shtyu tē ikte, more, tē poshterin. (Hyn xha Jashoja, Zyloja e disa partizanë tē armatosur. Kanë vënë përpara Zarikun e lidhur)

XHA JASHOJA: Ta solla spiunin, o Rrapo. Ja ku e ke.
(Shtyn Zarikun. Pauzë)

RRAPOJA: Zgjidhjani duart. (Zyloja e zgjidh) Ku e gjetët?

ZYLOJA: Ishte fshehur nē kasollen e Qanos. Siç duket, priste Salun me gjermanët!

RRAPOJA: I lajmërove?

ZARIKU: Jo!

RRAPOJA: Pse?

ZARIKU: Pashë që më kërkonin... Nga frika se mos më zinin, u fsheha.

RRAPOJA: Çfarë detyrash të kishin ngarkuar? Përgjigju po të them!

XHA JASHOJA: E kishin ngarkuar të të vriste ty, o Rrapo.

RRAPOJA: Pse?

XHA JASHOJA: Kishte shpresë të mirrte drejtimin e batalionit. Kështu tha Qanoja përpara se ta pushkatonim.

RRAPOJA: Përse nuk më vrave?

ZARIKU: Erdhi komisari dhe m'i prishi planet!

RRAPOJA: Tjetër? (*Zariku hesht.*)

ZYLOJA: Pastaj e urdhëruan të vriste komisarin! (*Reagime nga partizanët.*)

RRAPOJA: Zarik, cila bushtër të polli ty? Gjer këtu të arrijë njeriu, more shokë?! Mua të më vrisje njëqind herë, veç komisarin jo. (*Bërtet*) Jo, jo, dëgjon! Po për cilin lufton komisari, more firaun, more këlysh i bushtërës më të keqe të dynjasë? Për këtë tokë lufton komisari bashkë me ne, për këta njerëz e këto fshatra, more gjak i ndyrë. (*Nxjerr nagantin*)

ZARIKU: Nuk e desha Memon, as ty s'të desha, unë të gjithëve...

RRAPOJA: (*Qëllon*) As me gjak nuk e paguan tradhëtinë tënde, more çapaçul i fëlliqr!

DO TË MARRIM PAS EMRIN E TIJ

Luftha është ndezur e ashpër. Ka disa orë që luftohet. Rrapoja me disa partizanë vrojtojnë betejën.

MEVLANI: Komandant, më duket se po i marrin krahët Xhodos!

RRAPOJA: Mos more!

MEVLANI: Tani ka rrezik t'i dalin Fates nga prapa. (*Hyn komisari*)

MEMOJA: E, Rrapo, s'ka ardhur ndonjë haber nga Fatja?

RRAPOJA: Jo, or Memo, jo!

MEMOJA: Po të tjerët?

RRAPOJA: Vetëm Maku ka dërguar korrier.

MEMOJA: Ç'thotë?

RRAPOJA: Pret të ndeshet me gjermanët.

MEMOJA: Siç duket, ata kujtojnë se forca kryesore e batalionit është sektori i Fates, prandaj po përqëndrohen atje.

RRAPOJA: Ta marrë djalli, ta marrë. Sa herë i porositëm që të na njoftojnë me korrier, meazallah se u mbushet rradakja. Haramsëzë janë, pér nder! (*Luftimet ndizen në një krah.*)

MEVLANI: Komandant, u ndez nga Fatja.

RRAPOJA: (*Vështron*) Bobo, po e rrëthojnë të shkretin. (*Fillojnë luftimet dhe nga krahët e tjerë*)

MEMOJA: Të poshtërit! Te gryka kanë futur vetëm disa forca, ato kryesoret kanë çarë nga Xhodoja!

RRAPOJA: I ziu Fate.

MEMOJA: Prit, o Rrapo, të marrim vesh se ç'bëhet!

RRAPOJA: Më duket se e humba batalionin.

MEMOJA: (*E shkund*) Mblidh mendjen, Rrapo!

RRAPOJA: Do të kenë marrë me vete ndonjë kompani alpinistësh. Mbeti i rrëthuar batalioni, Memo. I ziu unë. Si e dreqosa kështu, Memo?

MEMOJA: Rrapo! Duhet t'i ndalojmë medoemos.

RRAPOJA: Ç'të bëjmë? (*Hyn Nafija*)

NAFIJA: Komandanti Rrapo! Më dërgoi Mak Mokra t'ju them se Faten po e rrëthojnë. Kërkon ndihmë.

RRAPOJA: Bobo! (*Pauzë*)

MEMOJA: Nafije!

NAFIJA: Urdhëro, shoku komisar!

MEMOJA: Te ju s'kanë sulmuar gjermanët?

NAFIJA: Jo.

MEMOJA: Mirë. Rrapo, unë po marr Nurkën me dykëmbëshin dhe disa partizanë nga Mokra dhe po shkoj në ndihmë të Fates. (*Thérret.*) Nurkë!

NURKA: (*Afrohet*) Urdhëro, shoku komisar!

MEMOJA: Merr dykëmbëshin dhe hajde me mua!

NURKA: Si urdhëron, shoku komisar! (*Largo het.*)

MEMOJA: Po u dalim gjermanëve nga prapa dhe po u hidhemi përsipër. Ti bëj ç'mos që t'i shtysh ata të poshtër nga krahu tjetër, në drejtim të Hodos. (*Del komisari. Pauzë*)

RRAPOJA: Pisk e ke punën, o Fate vëllai, mbahu edhe pak sa të arrijë komisari. Pastaj do ta marrin vesh ata këlyshët e bushtrave. Mevlani!

MEVLANI: Urdhëro, komandant!

RRAPOJA: Sa të arrijë komisari, do të marrësh skuadrën, do të varesh poshtë dhe do t'i ndjellësh gjermanët me zjarr.

MEVLANI: Ku t'i çoj?

RRAPOJA: Tërhiqi për nga Hodo Allamani.

MEVLANI: Ashtu siç tha komisari!

RRAPOJA: Po! T'i fusim në mes të Hodos dhe Makut e t'i shfarosim! (*Mbajnë vesh luftimet*) Po ky Xhodja, përse nuk dërgon korrier xhanëm! S'dimë ç'bëhet andej.

MEVLANI: Do ta ketë pisk, o komandant!

RRAPOJA: Posi! Haramsëzë janë! Pyka janë! (*Pauzë*)

MEVLANI: Komandant, po ngjitet një kolonë drejt nesh. Mos na rrethojnë?

RRAPOJA: (*Vështron*) Janë tanët, Mevlani!

MEVLANI: Duken si gjermanë.

RRAPOJA: (*Vështron me dylbi*) Jo, jo, është Xhemali,
vjen nga krahу i Hodos. E paskan çarë rrëthimin.

MEVLANI: Po afrohen.

RRAPOJA: Kujdes mos qëllojnë.

MEVLANI: (*Bërtet.*) Mos qëlloni, shokë, janë tanët. (*Dëgjohen luftime.*) Ia veshi Mak Mokra më duket.

RRAPOJA: Shumë mirë! Po i shkojnë Hodos si cјapi te kasapi. Tani do t'i bëjmë çapaçulët fértele.

XHEMALI: (*Bërtet nga jashtë*) A mbahesh, komandanti Rrapo?

RRAPOJA: Ku je, o Xhemal Porodina; se e bëre fora!
(*Hyn Xhemali me disa partizanë*)

XHEMALI: E, komandant, si duken punët këtej?

RRAPOJA: Hajde, trim i Rrapos, hajde! (*Përqafohen*)
Të them të drejtën na hyri frika.

XHEMALI: Po pse, o komandant?

RRAPOJA: Kujtuam se po na rrëthojnë, horrat!

XHEMALI: Përkundrazi një kompani e Saliut u shpartallua fare. Ai i pagoi krimet që kishte bërë.

RRAPOJA: Eh, qeni, biri i qenit, ma kafshoi dhenë.

XHEMALI: Hodo Allamani dhe Xhodo Greni i kanë vënë
në mes dy zjarresh dhe po bëjnë kërdinë mbi gjermanët.

RRAPOJA: E, m'u lumtë dora!

XHEMALI: Po komisari, ku është?

RRAPOJA: Ka shkuar në ndihmë të Fates. (*Dëgjohen luftime të ashpra*)

MEVLANI: Janë nga Fatja. Ky është dykëmbëshi i Nürkës. E njoh mirë.

RRAPOJA: Ku je, o Fate vëllai, se e tunde sot. Hajde, o komisar i Rrapos, hajde. Shkove dhe e ndryshove situatën. (*Vjen Fatja, i zbetë*)

FATJA: Komandanti Rrapo! Komisarin na e vranë! (*Të gjithë shtangën. Partizanët grumbullohen ngadalë.*)

Mbi një vig sjellin trupin e komisarit tē vrarë. Rrapoja bie nē gjunjë dhe vështron ftyyrën e ngrirë tē komisarit.)

RRAPOJA: Na e vranë komisarin, Xhemal! (*Rrapon e tradhtojnë lotët. Përbahet. Ngrihet me zor, i hedh dorën nē sup Xhemalit dhe përsërit tē njëjtën frazë.*) Na e vranë komisarin, Xhemal! (*Heshtje e rëndë*) Eh, Memo! I le shokët, Memo! (*Pauzë. Duke mposhtur emocionin përbledh forcat dhe u drejtohet partizanëve*). Partizanë... edhe partizane! Ne po ndahemi nga komisari. Na lanë pa Memon, shokun tonë tē dashur. Po ne do ta marrim pas emrin e tij, gjersë tē mos mbetet asnjë këmbë gjermani, ballisti dhe tradhtari. Cila ishte ëndrra e tij? Ju pyes: cila ishte? Liria dhe komunizma. Ne do tē luftojmë përlirinë dhe komunizmën. Betohemi!

TË GJITHË: Betohemi!

RRAPOJA: Djema! Ngrini kokat lart! Si na ka mësuar komisari? Dhembjen duhet ta kthejmë në forcë e urrejtje dhe tē sulemi kundër armiqve dhe tradhtarëve! Le t'ia marrim njëherë asaj këngës që na ka mësuar komisari.

(*Fillon tē këndoje fjalët e para tē «Internacionales». Njëri pas tjetrit e pasojnë gjithë partizanët. Kënga buçet e fuqishme. Komandanti Rrapo ngrë nagantin drejt qiellit dhe qëllon disa herë si përshtëndetje tē fundit për komisarin Memo. Disa partizanë ngrënë lart vigun që mban trupin e komisarit. Në ballë qëndron një partizan që mban flamurin e batalionit që valvitet nga era. «Internacionalja, buçet e madhërishme.*)

FUND